REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 307/19
Datë/Datum. 13.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KK Prizren

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 622-19-1256-1-1-1

Sa i përket tenderit për Furnizimi me zhavorr për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit

ANKESË

*1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK : NPN**"Renelual Tahiri"Shpk***

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rruga e Jonit 92/2,Prizren

(Adresa)

Prizren

(Vendi) *(Kodi postar)20 000*

(Numri Telefonit) ***044 128 112*** *(Numri i Faks-it)*

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)**Yll Hoxha***

(Adresa elektronike)renelual_tahiri@hotmail.com

12.06.2019

(Data e parashtrimit të kërkesës)

Ndërmarrje prodhim, tregti, ndërtimtari, transport export - import RENELUAL TAHIRI Shpk Zhur - PRIZREN

(Vënshkrimi dhe vulat)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

-Njoftimi për kontratë në KRPP është bërë me 15.03.2019,
-Afati i fundit për dorezimin ofertave ka qenë me dt.30.04.2019 dhe hapja është bërë me të njejtën ditë,
-Kërkes për informacione shtesë me 03.04.2019
-Letra standarde për tenderuesit e eliminuar 31.05.2019,
-Letra standarde për tenderuesin e sukseshëm31.05.2019,
-Njoftimi për dhënie të kontratës 31.05.2019,
-Kërkesë për ri-shqyrtim pranë AK me dt.03.06.2019,
-Vendimi për refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim nga AK me 06.06.2019
-Kriter për dhënie të kontratës tenderi i përgjegjshëm me qmim më të ulët.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Bazuar në nenin 109 të LPP parashtrojmë Ankesë pranë OSHP kundër vendimit të AK Komuna e Prizrenit me të cilin refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim për aktiviteti i prokurimit" :"Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit."me nr.të aktivitetit të prokurimit:622-19-019-111.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] Jo [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me rastin e njoftimin e dhënjes së kontratës dhe refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim për aktiviteti i prokurimit" :"Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit."me nr.të aktivitetit të prokurimit:622-19-019-111. ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e neneve të LPP-së si më poshtë:
Nenin 1,
Neni 6,
Neni 7,
Neni 10,
Neni 53,
Neni 59,
Neni 60,
Neni 69,
Neni 72,

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si OE i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit ashtu kemi aplikuar për këtë aktivitet të prokurimit me dt.30.04.2019 dhe kemi dorëzuar ofertën tonë e cila sipas AK nuk ka qenë e përgjegjshme me arsyetimin sipas letrës standarde për tenderuesit e pa sukseshm se në ofertën tonë mungojnë "Projektet e natyrës së kontratës realizuar në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të njoftimit)e vërtetuar nga OE,ku përfshihen titujt e projekteve,numri,data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre,vlera

minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.500.000 euro"nga AK me dt.31.05.2019 kemi pranuar njoftimin për eliminimin përmes kësaj letre standarde për tenderuesit e pa sukseshëm.

Me dt.03.06.2019 kemi parashtuar kërkesë për ri-shqyrtim me pretendimin ankimor se AK me rastin e eliminimit tonë nga aktiviteti i prokurimit:"Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit."me nr.të aktivitetit të prokurimit:622-19-019-111.ka shkel diapozitat e nenit 1,6,7,10,53,59,60,69 dhe 72 të LPP-së sepse ne kemi plotësuar kërkesat e DT dhe NJK lidhur me projektet e realizuar në tri vitet e fundit,po ashtu AK nuk ka dhënë sqarime shtesë lidhur me kërkesën tonë drejtuar AK me dt.03.04.2019 dhe nuk ka dëshmi të mjaftuar se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar me referencë aktivitetin e prokurimit me nr.622-15-319-111 të dëshmuar me procesverbalet dhe pagesa në bankë.
AK me dt.06.06.2019 merr vendim me të cilin refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim se komisioni i vlerësimit ka llogarit të gjitha referencat e natyrës së kontratës dhe kjo listë me këto shuma nuk arrin ta plotësoj vlerën e kërkuar dhe arsye e dytë e këtij vendimi se kemi pranuar informata nga komisioni se cilat referenca pranohen.

Po ashtu me të njejtën datë me 31.05.2019 përmes letrës standarde për tenderuesit e sukseshm njoftohemi se tenderues i sukseshëm për këtë AK është OE"Eurovia"Shpk.

Konsiderojm se lidhur me këto veprime Autoriteti Kontraktues Komuna e Prizrenit ka bërë:

-Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-ës dhe
-Vërtetim të gabuar të gjendjesë faktike.

Ne si OE pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk pajtohemi me vendimin e AK lidhur me arsyet e cekura në këtë vendim.
AK me këtë vendim ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 53 të LPP-së sepse pas kërkesës tonë të dt.03.04.2019 për informacione shtesë se cilat referenca prahohen të njejtit vetëm rekomandojnë që të keni parasysh kritetret e DT dhe NJK.
Nga paramasa e DT ne kemi gjetur se gati fare pak kemi të bëjmë me furnizim me zhavor për këtë aktivitet të prokurimit,por kemi të bëjmë me betonim armim vendosje të gypave,hapja e kanaleve,transporti i makinerive,ndërtim i murit mbrojtës,nga kjo paramas gjejmë vetëm tri pozicione ku kemi të bëjmë me furnizim me zhavor ndërsa pozicionet tjera kemi të bëjmë me punë,për këtë ne kemi shprehur shqetsimet lidhur me referencat sepse AK ka kërkuar furnizime me zhavor në vlerë prej 1.500.000 euro.
Nëse shiqojmë ofertat e OE pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit gjejmë se vetëm OE i rekomanduar për kontratë ka "plotësuar"me dyshime kërkesat e AK .
Kjo është bër me qëllim të caktuar dhe paraprakisht është ditë rezultati se kush është i preferuari i AK pë tu rekomanduar për kontratë.
Nëse shiqojmë listën e kontratave dhe referencat nga oferta jonë gjejmë po thuajse paramasat identike me ato për këtë aktivitet të prokurimit,ne nuk kuptojm akoma se qka kanë dëshiruar AK me furnizim me zhavor a kemi të bëjmë vetëm furnizimi,grumbullimi i zhavorit në një vend të caktuar dhe sa ashtë e vlersueshme dhe domethanse,e rëndësishme kërkesa prej 1.500.000 euro referenca me këtë vlerë për furnizim me zhavor,sa komplekse është ky aktivitet i prokurimit të kërkohen kërkesa të tilla por një e vërtet se këtu kemi të bëjmë me dyshime të bazuara për kurdisje të tenderit.....!

Si ka mundësi që nga një mal me referenca që kemi ofruar AK nuk i merr parasysh kur me mijra herë është ma komplekse ndërtimi i rrugëve ku për ndërtimin e saj nevoitet edhe zhavor,pastrim tereni,ngjeshje,betonim armim asfalltim etj,etj se një furnizim me zhavor,këto rrugë që janë ndërtuar a kan sasi dhe të zhavorit apo jan ndërtuar me pambuk që AK nuk i pranon referencat është për keqardhje dhe është nevritëse veprimet e AK.

Në përgjigjen e dytë të AK lidhur me kërkesën për ri-shqyrtim vetëm tërthorazi përmendet se rekomandimi i komisionit ka qenë referoju DT dhe NJK se cilat referenca pranohen.
Sikur AK të jepte përgjigje konform nenit 53 ne do të shqyrtonim pozicionin tonë se duhet të marrim pjesë në këtë aktivitet të prokurimit edhe ashtu i destinuar paraprakisht pë OE "Eurivia".

Andaj ne nuk pajtohemi me eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit,arsyet e cekura nga AK janë të pa vërteta,jo profesionale dhe irituese sepse nga këto shifet tendencë për eliminim dhe shpërblim me kontratë OE të caktuar.

Nga kjo shifet qartë se AK ka dështuar me rastin e vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve në atë mënyrë duke bërë shkelje të dispozitave të lartë cekura të LPP-së nga kjo mund të konkludojmë se vlersimi ka qenë subjektiv dhe jo profesional i ofertave dhe .....!!!!

Nga kjo që u tha më lartë gjejmë se AK me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e kanë përcjell një sërë shkelje të njëpasnjëshme gjatë vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve duke anashkaluar qëllimin dhe parimet e prokurimit publik për të cilën AK është i thirrur dhe obliguar të zbatoj sipas ligjit.
Me këtë rast AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 gjatë vlerësimit të tenderëve sepse nuk ka përdor nenit 59.2 dhe 59.4 kur kemi të bëjmë me ofertë me qmim më të ulëtë e cila ndërlidhet me nenin 72 të po këtij Ligji.

AK me eliminimin tonë si OE të cilit kemi pas ofertën tonë me qmim më të ulët ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat i nenit 1.1 të LPPës:
" 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese,koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Po ashtu edhe neni 6 i LPP-së i obligon AK të sigurojnë fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike citat i nenit 6 të LPP-së:
" Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion

sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar në të gjeturat mund të konkludojmë se AK nuk ka pas qëlliin e ruajtjesë së paras publike,ka vepruar në kundërshtim me parimet në të cilat mbështetet prokurimi publik,veprimet e AK qojnë në shkelje të kritereve të cilat vetë AK i ka parashikuar në DT dhe njoftimin për kontratë,jo transparenca ka qenë evidente tekë vlersimi i ofertave dhe përgjegjja lidhur me kërkesën për informacione shtesë,AK gjatë tërë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka qenë i një anshëm dhe veprimet e tyre janë dikriminuse dhe favorizuese për OE të caktuar duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7 të LPP-ës.

Andaj kërkoj nga Organi Shqyrtues i Prokurimit si instituacion autoritativ që me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese për aktiviteti i prokurimit:"Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit."me nr.të aktivitetit të prokurimit:622-19-019-111të mer këtë:

VENDIM

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE"Renelual Tahiri" nga Prizreni lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin"Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit."me nr.të aktivitetit të prokurimit:622-19-019-111.

2.Anulohet vendimi i AK për eliminim të OE"Renelual Tahiri" nga Prizreni lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin" Furnizim me zhavor për rrugët e pa asfaltuara të Komunës së Prizrenit."me nr.të aktivitetit të prokurimit:622-19-019-111 dhe lënda kthehet në ***ri-vlerësim.***

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Shpenzimet e përgaditjesë së tenderit,
Sigurimi i tenderit,
Shpezimet e ankesës.
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planifikuar për këtë tender

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*